



*E mërkurë, 2 gusht 2016*

## NJOFTIM

### **Vizita e Komisionit parlamentar për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri në ZRRE**

Anëtarë të Komisionit parlamentar për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri të udhëhequr nga kryetari i komisionit Z. Muhamet Mustafa, dje, 2 gusht 2016, kanë vizituar Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE).

Përfaqësuesit e Komisionit janë takuar me anëtarët e Bordit të ZRRE për tu njoftuar nga afër me zhvillimet në lidhje me rregullimin e sektorit të energjisë.

Kryesuesi i Bordit të ZRRE, Z. Enever Halimi, ka njoftuar anëtarët e Komisionit Parlamentar me obligimet dhe sfidat me të cilat është duke u përballë ZRRE si dhe me vendimet e nxjerra nga Bordi i tanishëm. Në këtë aspekt, Kryesuesi Halimi, ka theksuar vendimin për tarifën e energjisë elektrike, me të cilin vendim Bordi ka miratuar zvogëlimin e tarifave për konsumatorët komercial dhe Industrial deri në 8%.

Gjithashtu, Komisioni është njoftuar se ZRRE ka pranuar dhe proceduar 49 aplikacione për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtërishme. Siç është thënë nga këto aplikacione, 16 prej tyre tashmë kanë marr autorizimet finale për ndërtim dhe 6 nga këto projekte kanë përfunduar dhe janë duke prodhuar energji elektrike me një kapacitet të instaluar prej rreth 27 MW. Ndërsa 10 të tjera janë në faza të ndryshme të ndërtimit dhe përbëjnë një kapacitet të instaluar prej 53 MW.

Komisioni është njoftuar edhe për finalizimin e rregullave të çmimeve për energjinë termike, si dhe rreth përgatitjes së metodologjisë së përcaktimit të tarifave nxitëse për energjinë e prodhuar nga Biomasa, dhe rreth metodologjisë së përcaktimit të prodhimit të energjisë për vetë-konsum.

Përfaqësuesit e Komisionit Parlamentar janë interesuar në lidhje me rekomandimet e Komisionit nga shqyrtimi i Raportit Vjetor të ZRRE për vitin 2015, për të cilat Bordi i ZRRE ka njoftuar se është duke i adresuar dhe së shpejti do ti përcjellë Komisionit raportin në lidhje me adresimin e këtyre rekomandimeve.

Po ashtu përfaqësuesit e Komisionit janë interesuar të dinë në lidhje me tarifën e ardhshme të energjisë termike. Anëtarët e Bordit kanë njoftuar se tashmë ZRRE ka filluar procesin e shqyrtimit tarifor për këto shërbime dhe është duke mbledhur të dhënat nga të licencuarit për llogaritjen e kostove të tyre, në mënyrë që para fillimit të zezonës së ardhshme të ngrohjes të marr vendimin për tarifën e reja.

Përfaqësuesit e ZRRE kanë theksuar obligimet që dalin nga pakoja e re e ligjeve të energjisë e cila obligon ZRRE që brenda 9 muajve të bëjë harmonizimin e legjislacionit sekondar me atë primar. Me



këtë rast Kryesuesi Halimi ka theksuar se: “Implementimi i pakos së tretë të ligjeve paraqet një punë jashtëzakonisht të madhe, kështu detyra e përgjithshme e implementimit nuk do duhet të shihet vetëm përputhshmëri legislative, por si një ripërtëritje fundamentale e komercializimit të këtij sektori esencial, që do të mundësojë Kosovës të zgjidh gjendjen e saj të furnizimit me energji elektrike në mënyrë të qëndrueshme për të ardhmen.

Si sfida kryesore janë theksuar implemtimi i marrëveshjes për energjinë, e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, që ka të bëjë me rregullimin e konsumatorëve në veri të lumit Ibër, dhe njohja e Operatorit të sistemit të Transmisionit si zonë bllok rregulluese. Sfidë tjetër për ZRRE është theksuar largimi i plotë i ndërsuvencioneve ndërmjet kategorive tarifore të konsumatorëve të rregulluar.

Sa i përket hapjes së tregut të energjisë elektrike, ZRRE ka njoftuar se është duke punuar në përgatitjen e udhëzuesit dhe planit të punës, të cilët do të harmonizohen me strategjinë e energjisë pas aprovimit të saj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Sa i përket planit të punës është theksuar se do të diskutohet edhe me palët e tjera të sektorit për të gjetur zgjidhjet më të mira të mundshme në këtë drejtim.

Përfaqësuesit e Komisionit kanë shprehur konsideratën e tyre për punën që po bënë ZRRE dhe kanë kërkuar përkushtim edhe më të madh në realizimin e detyrave për rregullimin e sektorit të energjisë si një ndër sektorët më të rëndësishëm në vend.